

[www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al)



REVISTA DIGJITALE

# DIALOG JURIDIK

REFLEKTIME GJYQËSORE

2026

## Ligji i zbatueshëm në veprimet juridike, për testeamente me elemente të huaj

Nga av. Arben A. Hakani<sup>1</sup>  
Studio ligjore “Hakani & Associates” SHPK  
Dhoma e Avokatisë Tiranë

1. Disa nga parimet e të drejtës civile mbi të cilat mbështetet ky shkrim janë: parimi unitar ose zbatimi i një ligji në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje; përzierja e legjislacioneve; kolizioni - konflikti (përplasja); preferimi i ligjeve alternative, në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje dhe parimi *favor testamentii*.

2. Një nga sfidat e sotme për gjykatat civile shqiptare është dhe përcaktimi i ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridike civile, tregtare etj., tashmë mjaft të larmishme e të shumëllojshme, si në subjekte, ashtu edhe në përmbajtjen dhe natyrën e tyre. Arsyeja qëndron tek fakti se marrëdhëniet nuk lidhen, ndryshohen ose shuhet vetëm mes subjekteve shqiptare, brenda territorit ose që mbështeten në ligjin shqiptar. Disa konflikte rrjedhin dhe nga marrëdhënie juridike të cilat, nisur nga subjektet, objekti ose përmbajtja, konsiderohen me elemente të huaj<sup>2</sup>, që në aspektin e ligjit të zbatueshëm kërkon një këndvështrim më të gjerë e të kujdesshëm.

E ardhmja mendohet të jetë edhe më e ndërlikuar, nisur nga fakti se rreth 1/3 e popullsisë shqiptare me një apo dy shtetësi, si banorë ose me qëndrim të zakonshëm gjenden kudo në kontinent e më gjerë, shumë prej të cilëve kanë pasuri ose zhvillojnë aktivitete tregtare edhe në Shqipëri. Këto zhvillime, të shoqëruara me rritjen ekonomike, paraqesin një problem nëse prej tyre kërkohet që marrëdhëniet të zgjidhen ose të ekzekutohen në Shqipëri. Në këto raste, para gjykatës shqiptare shtrohet për diskutim pyetja se, cilit ligj duhet t’i referohet?<sup>3</sup> Ligjit të marrëdhënies objekt kontrolli, ligjit shqiptar, të shtetësisë, të vendqëndrimit të zakonshëm etj?

3. Problematika paraqitet disi më e lehtë për marrëdhëniet-veprimet juridike mes të gjallëve (*inter vivos*), pasi për to vepron parimi i gjithëpranuar “i lirisë kontraktore”<sup>4</sup>, sipas të cilit janë palët që formulojnë rregullat e kontratës, ligjin, madje dhe organin kompetent në rast konflikti. Situata nuk është e tillë në marrëdhëniet juridike të trashëgimisë, sidomos në atë testamentare (*mortis causa*). Dihet se këtij akti unipersonal të qenësishëm formal në çdo kohë i revokueshëm, vlefshmëria i kontrollohet vetëm nga të tretët, pra pa praninë e disponuesit trashëgimlënës (në vijim *de cuius*). Në një trashëgimi të çelur nuk është më si dikur, që koha dhe vendi i çeljes kontrollohej sipas ligjit shqiptar, kjo për faktin se konceptet shekullore të përkufizimit të shtetit mbi territorin dhe shtrirjen e ligjit në hapësirë, referuar dukurive të mësipërme, i kanë humbur deri diku funksionet e tyre klasike. Janë me dhjetëra raste kur është ushtruar kontroll për vlefshmëri të testeamenteve ose revokimi i tyre nga gjykatat, me elemente të huaj (kryesisht si akt juridik i krijuar jashtë), shumica e të cilave ka rezultuar se për zgjidhje si *referim*<sup>5</sup> kanë pasur kryesisht ligjin shqiptar që përbën dhe objektin e këtij shkrimi.

4. Për studiuesit dhe të interesuarit shtrohen për diskutim pyetjet: A ka dhe sa mund të jetë ndikimi i një ligji të huaj gjatë dhënies fuqi një testeamenti me elemente të huaj në Shqipëri? Mund të konkurrojnë apo mund të zbatohen njëherësh disa ligje apo legjislacione (vendas dhe të huaj) gjatë kontrollit të tyre? Mund të ndodhë të jemi para një kolizioni ose përplasje (konflikti) të ligjeve

<sup>1</sup>. Ushtron profesionin e avokatit në Tiranë prej vitit 1993. Autor i librave; “Noteria në RSH” viti 2008 ribotuar në vitin 2010, “Trashëgimia testamentare legjislacioni dhe praktika gjyqësore” i vitit 2010, dhe “Aktet nga veprimtaria noteriale dhe kontrolli i tyre” botim i vitit 2021.

<sup>2</sup>. Neni 1 i ligjit 10424/2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”, i cili shfuqizoi ligjin nr. 3920/1964.

<sup>3</sup>. Është fjala vetëm për ligjin material ...

<sup>4</sup>. Për më tepër shihni përmbajtjen e nenit 45 të ligjit të mësipërm.

<sup>5</sup>. Neni 3 i tij titullohet “Referimi në ligjin e një shteti tjetër.”

për efekt zbatimi të ligjeve të shteteve të ndryshme ose dhe për testamentin vepron parimi “unitar i së drejtës” sipas së cilit, preferimi për caktimin e ligjit do të jetë ai i *shtetësisë së de cuius-it*.

5. Para shtjellimit të këtyre pyetjeve mendoj të theksohen disa karakteristika që e bëjnë të dallueshëm funksionimin e ligjit shqiptar për trashëgiminë në të drejtën ndërkombëtare private, veçanërisht për atë testamentare. Sistemi ligjor shqiptar i përket familjes së sistemit lindor atij “të fitimit” të trashëgimisë, i ndryshëm nga ai “i pranimit”, karakteristikë e sistemeve të *civil law*, *common law* dhe familjes *gjermanike*, gjë që e bën më të vështirë zgjidhjen e një çështjeje nëse ndërthurjen njëherësh dispozita të ligjeve që përfaqësojnë sisteme të ndryshme. Një tjetër karakteristikë e dallueshme e legjislacionit shqiptar që e ndërlikon referimin në një legjislacion të huaj është fakti se kontrolli i çdo trashëgimie të çelur kalon detyrimisht nëpërmjet filtrit të noterit, një aktivitet privat me funksionet e nëpunësit publik, kur në sistemet e mësipërme këtë funksion paraparak pothuajse e kanë gjykatat respektive. Në Shqipëri, në një konflikt gjyqësor për trashëgiminë, si shkak për t’ju drejtuar gjykatës janë vetëm aktet dhe vendimet e noterit, pra ai për trashëgiminë luan një funksion *quasi* gjyqësor.<sup>6</sup> Ndërkohë, për trashëgiminë testamentare ndiqen edhe disa procedura ekstra procedurale-formale krahasuar me trashëgiminë ligjore, rregulla që i mbulon ligji “Për Noterinë”. Është fjala për veprimet e regjistrimit dhe çeljes së testamentit, pa të cilat nuk mund të lëshohet dëshmia e trashëgimisë testamentare. Shtrohet për diskutim, a duhet të regjistrohet dhe të çelet një testament me elemente të huaj edhe kur zotësia, elementet formalë dhe forma e tij nuk rezultojnë sipas ligjit shqiptar?

6. Pavarësisht tendencës së sotme për ta liberalizuar edhe më tej kontrollin ndaj testamentit (*favor testamentii*)<sup>7</sup>, ai mbetet ende një akt mjaft delikat dhe i brishtë krahasuar me aktet e tjera juridiko-formale *inter vivos*, pasi ligjbërësit, në tërësi, jo vetëm janë “intolerantë” në parashikimin e elementeve detyrues formal të tij (gjuha, data, ora, identifikimi, gjeneralitetet, nënshkrimi etj.), por ato paraqiten të tilla edhe për kontrollin e zotësisë për të vepruar *de cuius-it*, për formën e lejuar, ashtu dhe përmbajtjen e disponimit testamentar. Duke i shtuar atyre edhe rregullat e testamenteve me elemente të huaj, problematika e ligjit të zbatueshëm paraqitet vërtet e koklavitur. Kështu, për një trashëgimi testamentare të çelur veprojnë një mori rregullash si: ligji i kohës dhe vendit të çeljes (jo për zotësinë dhe formën), ligji i shtetësisë, ai i hartimit të testamentit, i vendbanimit, i llojit dhe i vendndodhjes së pasurisë ose i vendqëndrimit të zakonshëm etj...

7. Sipas pikës 2, të nenit 1 të ligjit nr. 10428/2011, do të konsiderohet testament me element të huaj, “*çdo rrethanë juridike që lidhen me subjektin, përmbajtjen dhe objektin e një marrëdhënie me një sistem të caktuar*”. Nga ky rregull ose përkufizim kuptohet se, për të qenë para të drejtës për referim në një ligj tjetër, duhet të jenë përmbushur dy kushte. I pari, elementi i huaj (subjekt, objekt, përmbajtje) në një marrëdhënie; dhe, i dyti, që ligjet e shtetit referues të bëjnë pjesë në një sistem (familje) të caktuar me atë të vendit të ekzekutimit, p.sh. për trashëgiminë. Konkretisht, një testament i hartuar sipas ligjit të një shteti që përfaqëson sistemin e *common law* dhe përmbush kushtet për tu konsideruar me elemente të huaj, për kontrollin e tij për efekt ekzekutimi në një vend ose shtet të familjes të sistemit *civil law* apo *lindor* për trashëgiminë, nënkupton se referimi tek ligji i shtetit të hartimit edhe pse lejohet nuk mund të zbatohet nga gjykata e vendit të ekzekutimit, pasi nuk ndodhemi para sistemeve të njëjta. Gjithsesi, ky përbën problem juridik që elaborohet gjerësisht nga e drejta ndërkombëtare private.

<sup>6</sup>Prandaj, ashtu si gjykata edhe ai detyrohet të kontrollojë paraprakisht, nëse testamenti ka ose jo elemente të huaj (vula apostile nuk ka lidhje me këtë verifikim) për të vazhduar më tej me kontrollin e vlefshmërisë së tij.

<sup>7</sup> Në këtë shkrim mbështetem edhe tek libri i avokat A. A. Tartari i vitit 2011 “Trashëgimia për të drejtën ndërkombëtare private shqiptare” dhe në një sërë ligjesh apo marrëveshjesh ndërkombëtare për trashëgiminë në disa prej të cilave ka aderuar dhe vendi ynë. Shtojca I, Konventa “Për ligjin e zbatueshëm për trashëgiminë për shkak vdekje” (1 gusht 1989). Shtojca IV lidhur me kolizionin e ligjeve, Konventa e Bazelit e vitit 1972. Konventa e Hagës e vitit 1981 dhe Shtojca II “Për ligjin e zbatueshëm për trustet dhe njohjen e tyre 1962”, libri jeshil, ligji nr. 115/2012 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për konfliktet e ligjeve në lidhje me formën e disponimeve testamentare”, nenet 3 dhe 8 etj..

8. Momenti tjetër që duhet ezauruar është se kur mund të aplikohet “e drejta për referim” në ligjin e një shteti tjetër”, sipas nenit 3 të ligjit të mësipërm, nëse paraqitet për ekzekutim një testament me elemente të huaj. Kjo dispozitë parimore jep dy pamje juridike të ndryshme që duhet të mbahen parasysh. Tek pika 1 parashihen rregullat lejuese se kur gjykata duhet t’i referohet një ligji të huaj në një marrëdhënie juridike. Konkretisht, nëse kjo është parashikuar në këtë ligj, nëse rregullat e ligjit të atij shteti referojnë ligjin shqiptar, zbatohet ky i fundit edhe kur ligji i një shteti të huaj parashikon si referim ligjin e një shteti të tretë, zbatohet ligji këtij të fundit. Pra, që të zbatohet një ligj i huaj për kontrollin e një testamenti me elemente të huaj në Shqipëri, veç dy kushteve të mësipërme, duhet të jemi para një prej tre rasteve të pikës 1 të nenit 3. Por edhe nëse janë të përmbushura këto kushte sipas pikës 1, tek pika 2 e nenit 3, parashihet që për disa elemente thelbësore të veprimit juridik (pra dhe testamentet) nuk mund t’i referohesh ligjit të huaj për ekzekutimin e tij. Kështu, rregullat e ligjit të një shteti tjetër ndalohen të zbatohen në Shqipëri për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm dhe për formën e veprimit juridik.

9. Për një trashëgimi të çelur dhe për kontrollin e një testamenti me elemente të huaj ky ligj parasheh dhe rregulla me karakter të posaçëm, nenet 33, 34 dhe 35. Sipas nenit 33, dispozitë me përmbajtje mikse (parimore & posaçme), ligji i zbatueshëm në një trashëgimi të çelur (ligjore apo testamentare) me elemente të huaj, përcaktohet sipas llojit të pasurisë. Për sende të luajtshme do të jetë ligji i vendqëndrimit të zakonshëm të trashëgimlënësit në çastin e vdekjes. Ndërsa për pasuri të paluajtshme ligji i vendndodhjes së pasurisë, që do të thotë se për përmbajtjen e testamentit me elemente të huaj do të zbatohet nga gjykata ligji i territorit të vendndodhjes së pasurisë (*lex rei citae*), pra ligji shqiptar. Në pjesën e dytë norma paraqitet si dispozitë e posaçme, pasi, ndryshe nga neni 3 i këtij ligji, lejon që trashëgimlënësi (ligjor apo testamentar) të përzgjedhë si ligjin e zbatueshëm, ligjin e një shteti të caktuar për gjithë trashëgiminë e tij, me kushtin nëse provohet që në çastin e vdekjes ka pasur shtetësinë ose vendqëndrimin e zakonshëm të atij shteti. Edhe në këto raste, ai nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia rezervatarët ligjorë sipas nenit 379 të Kodit Civil. Pra përsëri për përmbajtjen e testamentit gjykata do t’i referohet ligjit shqiptar. Dispozita parashikon se, ashtu si rregullat që zbatohet për formën në rastet e revokimit të disponimit testamentar, do të zbatohen dhe në rastet e zgjedhjes, revokimit ose ndryshimit të ligjit të zbatueshëm. Zgjedhja e ligjit të zbatueshëm për trashëgiminë testamentare, mendoj se duhet të gjejë shprehje në përmbajtjen e testamentit, pasi heshtja prezumon se *de cuius-i* nuk ka caktuar ligj për trashëgiminë e tij.

10. Natyrshëm lind pyetja se, cili është ligji i zbatueshëm për kontrollin e vlefshmërisë së testamenteve me elemente të huaj, i paraqitur për tu ekzekutuar në Shqipëri, lidhur **me zotësinë** për të disponuar dhe **formën** ose revokimin e tij. Zotësia për të disponuar me testament, rregullohet vetëm sipas ligjit të shtetit, **shtetësinë**<sup>8</sup> (*lex nationali*) e të cilit testamentlënësi ka pasur në kohën e bërjes, ndryshimit ose revokimit të testamentit (neni 34 i ligjit). Ndërsa, lidhur me ligjin e zbatueshëm për kontrollin e formës së testamentit, ndryshe nga neni 3 i cili ashtu si për zgjedhjen e ligjit dhe për formën e veprimit juridik ndalon të zbatohet ligji i shtetit të huaj, neni 35 jep 4 alternativa përzgjedhjeje të barasvlefshme. Kështu, forma do të konsiderohet e rregullt nëse: a) rezulton sipas ligjit të shtetit ku është bërë testamenti (*lex loci actus*); b) sipas ligjit të shtetit të shtetësisë se *de cuius-it* në kohën e bërjes ose të vdekjes (*lex nationali*); c) ligji i shtetit të vendqëndrimit të zakonshëm në kohën e bërjes apo të vdekjes së tij (*lex domicili*); ç) ligji i shtetit i vendndodhjes së pasurisë së paluajtshme e disponuar me testament (*lex rei citae*).

11. I gjithë problemi i ngritur në këtë temë është për rastet kur një testament me elemente të huaj paraqitet për tu kontrolluar për vlefshmëri para **gjykatës shqiptare me juridiksion ndërkombëtar**. **Gjykata, do të zbatojë ligjin e shtetit shqiptar apo sipas elementeve ajo mund të zbatojë njëherësh dhe një a më shumë ligje të shteteve të tjera?** Referuar të drejtës

<sup>8</sup>. Në rast kur shtetasi shqiptar ka dhe një shtetësi të dytë, për ligjin e zbatueshëm prevalon e para, neni 8 i ligjit.

ndërkombëtare private, si ligj i zbatueshem për përmbajtjen e testamentit do të jetë ai i territorit të pasurisë së paluajtshme; për zotësinë për të disponuar do të jetë ai shtetësisë së *de cuius-it*; për formën, veç këtyre të dyjave, mund të zbatohet edhe ligji i vendqëndrimit të zakonshëm ose ai i vendit të bërjes së testamentit. Konkretisht: Për një testament me element të huaj i hartuar në Amerikë nga një shtetas italian i cili ka lënë shtetësinë shqiptare me disponime për pasuri të paluajtshme të ndodhura në Shqipëri, cilit ligj duhet t'i referohet gjykata shqiptare për kontrollin e vlefshmërisë së elementeve të tij? Për përmbajtjen i referohet ligjit shqiptar; për zotësinë ligjit të shtetësisë së *de cuius-it*, pra atij italian; për formën, përveç njërit prej këtyre të sipërcituar, mund t'i referohet dhe dy alternativave - të ligjit të bërjes së testamentit ose të vendqëndrimit të zakonshëm. Pra, me këtë argument, në varësi të elementeve, mund të ndodhë që, për kontrollin e tij, gjykata të bazohet në tre legjislacione të ndryshme: në atë shqiptar, në atë italian dhe në njërin prej shteteve të Amerikës, edhe nëse dy të fundit për formën dhe elementet formalë mund të bien ndesh me ligjin shqiptar.

12. Sipas ligjit të mësipërm dhe konventave ndërkombëtare ku ka aderuar ose jo Shqipëria, alternativa e zbatimit e një apo më shumë ligjeve të shteteve të ndryshme për kontrollin e një veprimi juridik me elemente të huaj, sidomos teste, varet dhe nga disa kushte, që mendoj se duhen mbajtur parasysh në rastet konkrete. Së pari që, ligji i shtetësisë shqiptare prevalon me ligjin e huaj, pra në një rast përplasjeje ligjesh, nga gjykata do të zbatohet ligji shqiptar. Së dyti, sipas nenit 1 të ligjit, që të jetë i zbatueshem një ligj i huaj, si rregull ai duhet të jetë brenda të njëjtit sistem (familje) të së drejtës me atë shqiptar, përndryshe e drejta për referim në një ligj të huaj është e vështirë të zbatohet. Së treti, pjesëmarrja në të njëjtin sistem familjeje duhet të shtrihet edhe për ligjin e përafërt të mosmarrëveshjes konkrete, pasi, nëse ka përplasje ose pamundësi kontrolli, edhe për formën mendoj se duhet të zbatohet ligji shqiptar. Kështu, fillimisht, kontrollin e elementeve formalë dhe formës së lejuar të një testamenti e bën noteri nëpërmjet veprimit të çeljes së trashëgimisë. Me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë prej noterit, trashëgimtari i caktuar, në Shqipëri bëhet *ipso iure* titullar i të drejtave trashëgimore. Ndërsa në shtetet e sistemit *common law*, *civil law* dhe ato gjermanike, veç faktit se regjistrimi i tij është i detyrueshem, kontrollin për zotësinë e trashëgimlënësit dhe formën ose elementet formalë, e ushtron kryesisht gjykata e posaçme sipas ligjit të shtetit ku është hartuar testamenti, e cila në këtë rast pezullon dhe trashëgiminë me një afat të caktuar që palët e interesuara mund të kontestojnë ose jo testamentin, për zotësinë, për formën dhe elementet e tij ose dhe për përmbajtjen.

13. Në përfundim, mendoj se gjykata shqiptare nuk ka autoritetin e plotë që, duke zbatuar një ligj të huaj, të konsiderojë të vlefshëm për efekt ekzekutimi një testament, akt i hartuar jashtë, nëse zotësia për të vepruar dhe forma ose elementet formalë të testamentit bien ndesh me ligjin shqiptar dhe nuk janë verifikuar nga organi sipas ligjit të shtetit ku është hartuar. Për të mbrojtur testamentin dhe shmangur çdo lloj interpretimi që mund t'i bëjë gjykata shqiptare një ligji të huaj në këto raste, edhe pse nuk duhet të ndalohet regjistrimi i tij (i apostiluar) nga noteri, çelja është e këshillueshme të kërkohet që të realizohet nga organet kompetente të vendit të lëshimit, pra sipas ligjit të vendit të hartimit të testamentit, sidomos kjo për vendet e sistemit *common law*. Akti i tyre provon se është respektuar ligji i shtetit të hartimit të testamentit si për zotësinë për të disponuar, ashtu edhe për formën apo elementet formalë. Ai, pasi homologohet, i hap rrugë lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë testamentare nga noteri, akt që mund t'i nënshtrohet përsëri kontrollit për vlefshmëri të testamentit nga gjykata, sipas ligjit shqiptar për trashëgiminë dhe vetëm për përmbajtjen e tij.

**Shembull:** Në vitet 2010 një shtetas shqiptar me leje qëndrimi të zakonshme në një shtet të sistemit *common law* harton para noterit shqiptar një testament duke disponuar në favor të vajzës pasuritë e tij të luajtshme të kudondodhura dhe ato të paluajtshme në Shqipëri. Rreth 3 vjet më pas, disa ditë para se të ndërronte jetë, nënshkruan një testament të hartuar nga një avokat-noter i atij shteti, me tekst të parapërgatitur në gjuhën angleze në elemente, formë dhe lloj të ndaluar nga ligji shqiptar, me anë të cilit revokon testamentin e parë dhe e disponon pasurinë në favor të

bashkëshortes. Kjo e fundit, edhe pse me qëndrim të përhershëm e të zakonshëm në atë shtet, nuk e regjistroi dhe çeli testamentin në atë shtet, por pasi i vendosi vulë apostile e paraqiti para një noteri shqiptar, i cili e përktheu, e regjistroi, e çeli dhe lëshoi dëshminë e trashëgimisë testamentare, pa i verifikuar zotësinë për të disponuar dhe as formën e lejuar nga ligji shqiptar. Në të njëjtën kohë, gjykata e shtetit përkatës refuzoi çeljen e testamentit të hartuar në Shqipëri nga i njëjti trashëgimlënës edhe pse testamentlënësi që kishte ndërruar jetë në shtetin e huaj, ishte shtetas me vendbanim dhe vendqëndrim po në atë shtet. Ajo e orientoi palën e interesuar që testamentin e hartuar në Shqipëri ta çelë dhe t'i japë fuqi po në Shqipëri, sipas ligjit shqiptar.

Tiranë, 9 Prill 2026.